



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR KOMUNITETE

Procesverbal nga mbledhja e XX-të (njëzet - mandati VII), e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 03 prill 2024

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, ndërtesa e Komunës, dhe filloi në orën 10;10

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Xhafer Ademi Kryesues i Komitetit për Komunitete.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti dhe atë: znj.Qëndresë Hajrizi, z.Florent Hasani, z.Arbnor Fazliu, znj.Shkurte Sejdiu, znj.Sevdije Mustafa, z.Selver Rama, z.Demokrat Hodolli, znj.Fikmete Qurkollli.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin edhe; Bahri Selimi-drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit DSHPMSH, Adelinë Stublla-drejtoresh e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Liman Zeqiri-shef i Zyrës Komunale për Komuniteteve dhe Kthim ZKKK, Fadil Babatinca-përfaqësues nga Stacioni i Policisë në Podujevë, Bekim Karaxhija përfaqësues i OSBE, Fitim Sejdiu-qytetar.

Rendi i ditës

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen, përshëndeti të pranishmit dhe iu dëshiroj punë të mbarë, ndër të tjera, theksoi, thirrjen dhe materialin për këtë mbledhje besoj e keni marrë me kohë të gjithë, andaj në vazhdim po i lexoj pikat e rendit të ditës dhe njëkohësisht pyes nëse ndokush dëshiron fjalën rreth rendit të ditës, nëse jo e hedh në votim rendin e ditës.

Njëzëri me 8 vota Për, nga të pranishmit miratohet rendi i ditës sipas thirrjes së kësaj mbledhje.

- 1. Informatë nga Drejtorja e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, rreth mundësive të realizmit të projekteve që ndikojnë drejtpërdrejtë tek Komunitetet jo shumicë, siç është projekti “Ndërtimi i rrjetit të ri të ujësjellësit në lagjen ku jetojnë komunitetet jo shumicë në rr.”Ali Ajeti” dhe rr.”Ulqini” në Podujevë.**

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, unë e kam njoftuar drejtorin e DSHPMSH për këtë pikë të rendit të ditës. Po ashtu ka një kohë të gjatë që e kam dërguar projektin dhe tani ka me vite që jemi në pritje të ndërrimit të gypit të ujësjellësit i cili paraqet shumë vështirësi për komunitetin jo shumicë në atë lagje, ndoshta mund të them se është gjendje jetike për shkak se ata gypa janë asbest dhe nëse mund të themi janë ndryshkur / kalbur dhe uji vie shumë i turbullt, por komuniteti po e përdor meqë nuk ka alternativ tjetër, kush i ka kushtet e blen ujin por kush nuk i ka e përdor atë ujë.

Ati uji profesionalisht i është bërë analizë dhe rekomandimi ka qenë që të mos përdoret për pije, apo fillimisht të vlohët e pastaj të pihet.

Për këtë problematik është njoftuar edhe Kryetari i Komunës i cili njëherë e mori përsipër për ta realizuar atë projekt në vitin e kaluar dhe e falënderoj shefin e ZKKK z.Liman Zeqiri për përkrahje të vazhdueshme në këtë projekt të cilin pastaj e kemi dorëzuar në DSHPMSH dhe deri tani nuk kemi marrë kurrfarë informate është aprovuar apo jo, prandaj për këtë qëllim sot e kemi thirr këtu në këtë takim të informohemi a po bëhet apo jo për t'u hapur rrugët për të vazhduar tutje duke kërkuar donator tjerë, përndryshe në këtë vit nuk guxojmë të na zë dimri me atë gyp sepse mund të ndodh të kemi ndonjë katastrofë nga helmimi i mundshëm edhe pse disa sëmundje të ngjashme janë shfaq por nuk kemi bërë analiza nga dhe si po vijne sëmundje në atë lagje.

Kështu që drejtorin e DSHPMSH e kemi ftuar dhe presim t'i bashkëngjitet kësaj mbledhje dhe të na jap sqarime dhe informata të nevojshme.

Nëse pajtoheni ne mund të kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës deri sa të vie drejtori i DSHPMSH.

Mbështet kërkesa e Kryesuesit që të vazhdohet me pikën e dytë të rendit të ditës deri sa të jetë prezent në mbledhje drejtori i DSHPMSH

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, meqë tani drejtori i DSHPMSH është prezent unë edhe njëherë po e përsëris në pika të shkurta se lagja në fjalë e cila e ka ujësjellësin por gypat janë asbest dhe janë të kalbura që një kohë të gjatë kështu që uji nuk është i pijshëm sepse ka disa mikroba në atë ujë dhe shumë herë i bie të intervenoj kompania e ujësjellësit.

Për këtë një Shoqatë mjekësore ka ardhur dhe ka bërë analizat e ujit ku pastaj ka sugjeruar të mos përdoret për pije ose të paktën të vlohët para se të pihet.

Në vitin e kaluar e kemi dorëzuar projektin për ujësjellës të ri dhe Kryetari i komunës e ka marrë përsipër për ta realizuar dhe për këtë është i njoftuar, mirëpo për shkaqe që nuk i di, ndoshta edhe mjete financiare nuk ka pas, nuk është realizuar edhe përkundër pritjes që kemi pasë se do të realizohet. Tani jemi në vitin e ri 2024 dhe sërish e kemi dorëzuar projektin në Komunë për ndërrimin e gypit të asbestit e që nëse në këtë vit nuk ndërrohet ai gyp është frik e komunitetit jo shumicë që jeton në atë lagje se mos po vie deri te ndonjë sëmundje / epidemi edhe më e madhe, kështu që Komuna të na tregoj nëse nuk mund ta realizoj atë projekt, neve na duhet të kërkojmë di ku tjetër mjete financiare apo financim të atij projekti me qëllim që ta bëjmë një rrugëdalje sepse përndryshe nuk guxon të na zë dimri pa u bërë ndërrimi i atij gypi, ose ose ne ta mbyllim gypin krejt dhe ta lëm lagjen pa ujë fare e që është më mirë se sa të vazhdohet siç është tani.

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, theksoi, nuk mendoj se i'u bie mirë ta mbyllni atë gyp dhe ujësjellësin në atë lagje ashtu siç po potenconi.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, nëse ndokush helmohet apo shfaqet ndonjë sëmundje, më tregoni ju cila është mënyrë më e mirë pastaj, a më mirë të ndalet uji krejt apo të ketë helmim të ndokujt dhe të ketë pasoja.

Kështu që besoj se do të bëhet diçka lidhur me këtë, ne e kemi dorëzuar projektin dhe tani presim të na kthehet përgjigje se a do të realizohet apo jo në mënyrë që të hapen rrugët për të kërkuar diku tjetër financim të projektit të cekur.

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, theksoi, sipas asaj që Kryesuesi po e potencon jemi në situatën ku po kërkohet të thuhet po ose jo, e që nuk bëhet në atë formë, mirëpo duhet bërë përpjekje gjithëherë të kryhet puna ashtu siç kemi bërë përpjekje edhe ne si Komunë ta realizojmë. Projekti me ujësjellësin në atë lagje është një problem i vjetër dhe problemi që ujësjellësi në atë lagje është sepse janë gypa të asbestit nuk është edhe problem aq i madh ashtu siç po e potencon ti Kryesuesi i këtij Komiteti ngase nuk është vetëm ai gyp por ka edhe shumë

lagje tjera në territorin e Komunës së Podujevës që furnizohen me ujë të pijshëm përmes gypave e ujësjellësit që janë asbest, pra nuk është vetëm ajo lagje.

Sa i përket asaj që e potencove se ka qenë një Shoqatë e cila ka bërë matjet / analizën e ujit në atë lagje, ne këto gjëra i dimë deri diku se qysh vijnë ato shoqata dhe qysh e bëjnë tragjike punën e ujit të pijes, prandaj largojeni nga koka që ai ujë është aq i dëmshëm për të ardhur deri tek ndonjë epidemi apo sëmundje sepse sërish po e them se nuk është rasti i vetëm dhe nuk është e vetmja lagje që ujësjellësin e ka me gypa të asbestit.

Lidhur me atë se çfarë kemi bërë ne si Komunë për ta rregulluar atë problem, së pari ne si Komunë nuk kemi mundësi të bëjmë projekte për ujësjellës sepse kjo është kompetencë komplet e KRU “Prishtina”, ata bëjnë zgjerim dhe mirëmbajtje të rrjetit të ujësjellësit ndërsa Komuna nuk ka asnjë shumë buxhetore të ndarë për zgjerim apo mirëmbajtje të ujësjellësit dhe rrjetit të ujit të pijshëm, mirëpo ne si Komunë për dy vite me radhë kemi bërë kërkesë në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal-MAPL e cila ka një fond buxhetor për ndihmë komuniteteve jo shumicë përkatësisht për financimin e projekteve që prekin jetën dhe kërkesat e komuniteteve.

Pra në vitin e kaluar e kemi dërguar atë projekt në MAPL por që përgjigja e tyre ka qenë se buxheti është i vogël dhe nuk kemi pas mundësi të ndajmë mjete për Podujevën për arsye se ajo Ministri ka të gjitha Komunat dhe nuk kanë mund të ndajnë diçka për Komunën e Podujevës, mirëpo si kërkesë ka mbete që të shqyrtohet në këtë vit që jemi por t’ju them të drejtën në këtë vit ne nuk kemi aplikuar me të njëjtin projekt në thirrjen publike që MAPL ka bërë për aplikim të financimit të projekteve, mirëpo jemi takuar me Ministrin e MAPL-së dhe atë jo më larg se mbrëmë unë personalisht jam takuar me Ministrin ku kemi biseduar për këtë çështje dhe ka mbete që ai të vizitoj Podujevën konkretisht në vizitë tek komunitetet jo shumicë si dhe me mundësi të nënshkrimit të një Memorandumi të Bashkëpunimit me të cilin do të premtohet ndarja e një shumë buxhetore për KRU “Prishtina” si përgjegjëse dhe kompetente për rrjetin e ujësjellësit, si dhe në bashkëpunim me neve si Komunë për ta rregulluar rrjetin e ujësjellësit në lagjen e cekur.

Pra kjo është situata aktuale se çfarë është bërë deri tani dhe çfarë pritet të behet për ndërrimin e atij gypi në lagjet ku jetojnë komuniteti jo shumicë në rr.”Ali Ajeti”, pra besoj se nuk shkon larg dhe Ministri i MAPL-së do të bëjë një vizitë dhe do të rregullohet kjo çështje sepse vetëm prej tij varet tani kjo, jo prej Komunës sepse asnjë kompetencë dhe asnjë shumë buxhetore nuk e ka Komuna për punë që ndërlidhen me ujësjellësin ngase kjo çështje ka kaluar si kompetencë dhe përgjegjësi e KRU “Prishtina”.

Pra kjo është sa i përket ujësjellësit dhe urdhëroni nëse keni ndonjë çështje tjetër. Unë kam edhe disa kërkesa tjera që janë paraqitur nga komunitetet jo shumicë dhe i kemi identifikuar secilën prej tyre qoftë në aspektin e kompetencave qoftë në aspektin e mundësive për realizmin e tyre e që jemi në përpjekje për t’i përfshirë në projekte për këtë vit, me theks ato që i përkasin DSHPMSH, por që ka edhe kërkesa që i përkasin edhe Drejtorive tjera e që sigurisht se do të përfshihen në buxhet dhe të realizohen. Brenda këtij viti besoj se një varg i kërkesave të komuniteteve jo shumicë do të kryhen, pra ato që i përkasin Komunës, kurse e përsëris se për ujësjellës është çështje tjetër.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, falënderoj drejtorin e DSHPMSH për informatat e dhëna, kështu që ne po presim derisa të vije në vizitë ministri i MAPL-së, mirëpo nëse edhe Ministri nuk e realizon këtë projekt atëherë po e marrim vetë në dorë këtë çështje.

z.Florent Hasani, theksoi, ne si LVV po ju tregojmë dhe ju thërrasim të besoni në organe, mirëpo edhe do ta inkurajojmë qeverisjen lokale që t’ju mbështes edhe pse nuk bëhet fjalë vetëm për komunitetin jo shumicë në këtë rast, por ka edhe raste tjera, shembull në lagjen ku jetoj unë

në rr.”Hasan Prishtina” kemi probleme me gypin e ujës-jellësit, mirëpo jemi të vetëdijshëm se nuk është çështje e Komunës dhe që e financon Komuna, por jemi duke pritur ngjashëm sikurse ju nga Ministria, normal me ndihmën e Komunës së Podujevës. Do të thotë ngjashëm kemi vepruar edhe ne sikurse kërkesat e juaja që janë paraqitur.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, ne vazhdimisht kemi besuar dhe besojmë në organet shtetërore dhe për këtë arsye kemi pritur deri ani. Sa i përket çështjes që kërkesa ka shkuar në Prishtinë / në nivel qendror unë nuk kam qenë i informuar deri tani.

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, theksoi, Kryesuesi i Komitetit e bëri tragjike një gyp vetëm për një lagje, mirëpo gypi kryesor i cili e bënë furnizimin kryesor të rezervuarit kryesor që vie nga “lagja e Dëshmorëve” deri te pishat, është i asbestit. Pra bëhet fjalë për gypin kryesor i cili furnizon gjithë qytetin, dhe tani jemi duke ndërruar atë gyp, ende nuk është bërë funksional.

Pra i tërë qyteti furnizohet me ujë të pijshëm përmes një gypi i cili është asbest, prandaj e thash se paska e kanë ekzagjeruar çështjen e asbestit, por i gjithë rrjeti i ujës-jellësit në të kaluarën është bërë me gypa të asbestit, vonë ka filluar me plastikë dhe normale që kërkon kohë të kthehet i tëri me gypa të plastikës, prandaj po e përsërisë se paksa ju kanë frikuar ajo shoqatë duke përmendur sëmundje e epidemi e të tjera, largojeni atë frikë sepse nuk qëndron ajo.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, gypi për të cilin po them unë është tepër i vjetër dhe është kalbur, përndryshe mund të vini të shihni dhe vetëm ta lëshoni çezmën ta mbushni një gotë dhe e shihni çfarë lloji i ujit është, asgjë nuk them tjetër sepse kjo është gjë e cila lehtë mund të verifikohet, e merr ujin në shishe apo gotë dhe e sheh se si është uji, pra kjo është gjë që shihet dhe nuk është ekzagjerim nga ana jonë.

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, theksoi, mund të ketë ndonjë problem, defekt apo rrjedhje ndokund ku mund të bëhet përzierja e ujit të pijes me ujëra atmosferike, kurse sa i përket gypit të asbestit ajo nuk qëndron sepse është çdo kund jo vetëm tek lagja juaj.

z.Fitim Sejdiu, qytetarë i Komunës së Podujevës nga radhët e komuniteti jo shumicë, mori fjalën dhe theksoi, edhe pse unë nuk jam pjesë e këtij Komiteti por megjithatë meqë jemi tek kjo temë që ndërliidhen me informatat në urbanizëm, unë jetoj në lagjen ku jetojnë komuniteti jo shumicë në rr.Xhafer Meta” e që kemi probleme me një prockë dhe kemi paraqitur kërkesa në Komunë.....

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, e mirëkuptoj parafolësin mirëpo në bazë të rregullave ligjore në fuqi qytetarët kanë të drejtë të jenë prezent në mbledhje të Komitetit për Komunitete por nuk kanë të drejtë të marrin fjalën dhe të ndërlyjnë në mbledhje, kështu që me keqardhje më duhet të ndërprej diskutimin i nderuar z.Fitim Sejdiu ngase jam i thirrur për të zbatuar rregulla dhe për ta drejtuar mbledhjen e Komitetit për Komunitete.

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, theksoi, sa e di unë kanë të drejtë të flasin edhe pjesëmarrësit në këtë Komitet, vetëm se nuk kanë të drejtë të votojnë meqë janë jashtë përbërjes së Komitetit.

znj.Adelinë Stublla, duke shpreh pajtueshmëri me parafolësin drejtorin DSHPMSH, theksoi, edhe unë mendoj se ka të drejtë të flasë personi në fjalë, të shpreh mendime dhe të jep ide të ndryshme

Zyrtari i përkatës i Zyrës Ligjore dhe për punë të Kuvendit, sqaroi se persona që janë prezent në cilësinë e qytetarëve dhe që nuk janë pjesë e Komitetit në këtë rast kanë të drejtë vetëm pjesëmarrje, nuk janë anëtar të Komitetit, përveç në qoftes e është ftuar enkas në mbledhje si përfaqësues i ndonjë lagjeje apo një grupi të caktuar të komuniteteve jo shumicë në këtë rast, kështu që me keqardhje e them se nuk jam në dijeni që ju është bërë ftesë.

Unë vetëm i tregova Kryesuesi rreth mbarëvajtjes dhe rregullave të mbledhjes, përndryshe fjalën nuk mund t'ju ndal unë fjalën, fjala mund t'ju jepet apo ndalet nga Kryesuesi i Komitetit. Gjithashtu ju sqaroj se janë debatet publike që organizohen nga Komuna dhe aty mund të shprehesh për çështje të ndryshme.

Të mos keqkuptohemi sepse unë vetëm i'a sqarova këtë çështje Kryesuesit ngase pastaj kjo rrjedhë e mbledhjes dhe këto diskutime mbeten në procesverbale dhe janë publike pastaj, Përndryshe po të ishte e drejtë të marrin fjalën kushdo atëherë nuk do të kishte përbërje të komitet fare por do të ftoheshin të gjithë në mbledhje dhe do t'ju jepej fjala të gjithëve e që mund të jenë 500 – 1000 persona.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, edhe njëherë kërkoi falje i nderuar z.Fitim Sejdiu, mirëpo këtë rregull unë nuk e kam ditur.

Tani kërkoi nga drejtori i DSHPMSH të na informoj edhe për projekte tjera për të cilat ka kërkesa dhe ankesa nga ana e komuniteteve jo shumicë.

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, theksoi, kërkesat që janë parashtruar nga komunitetet jo shumicë dhe që janë në domenin e DSHPMSH, janë si në vijim; në fshatin Batllavë është kërkuar ndërtimi i një trotuari që kalon nga rruga kryesore në drejtim të lagjes ku jetojnë komuniteti jo shumicë dhe përfundon tek shkolla, projekt të cilin t'ju them të drejtën kemi insistuar ta kryejmë në vitin e kaluar por projekti i MAPL-së që e ceka më herët na është heq nga planifikimet tona. Gjithashtu në këtë fshat është kërkuar ndriçim publik dhe atë një pjesë e vogël me tri drita si dhe janë 2 rrugë të shkurtra të lagjeve për të cilat është kërkuar të ndërtohen me kubëza. Ndërsa çka është punuar në vitin e kaluar në fshatin Batllavë, është parkingu tek Shkolla dhe tek Xhamia që kanë qenë kërkesa të tyre.

Po ashtu në këtë fshat është kërkuar edhe hapja e një kanali në pjesën e epërme të rrugës në gjatësi rreth 500 metra ku ata po dyshojnë se është bllokuar dhe kur po ka reshje të mëdha po ka grumbullim të ujit aty dhe uji pastaj po i'u hyn në lagje dhe nëpër oborre, e që nuk është se paraqet ndonjë problem të madh por që na duhet të intervenojmë.

Në fshatin Orllan, në vitin e kaluar e kemi rregulluar 1 rrugë me kubëza, por tani është kërkuar të ndërtohen edhe 2 rrugë tjera e që mendoj se do të ndërtohen brenda këtij viti ngase kemi mundësi buxhetore dhe jemi afër lidhjes së një kontrate të re.

Pastaj në lagjen ku jetojnë komuniteti jo shumicë në rr."Xhafer Meta" në Podujevë është kërkuar një kanalizim i cili është paksa problem sepse është vjetërsuar dhe është brenda në lagje. Po ashtu në këtë lagje është kërkuar edhe ndërtim me kubëza dhe ndriçim publik.

Gjithashtu siç diskutuam kërkesë tjetër është edhe ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në lagjen ku jetojnë komunitetet jo shumicë në rr."Ali Ajeti" në Podujevë.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, falënderoj drejtorin parafolës edhe për këto informata dhe mbetemi me shpresë që këto kërkesa do të realizohen.

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, theksoi, megjithatë nëse ju si Komitet për Komunitete keni ndonjë kërkesë apo ankesë që prek komunitetin jo shumicë dhe që vlerësoni se është me prioritet dhe shumë e rëndësishme në secilën lagje apo fshat, mund ta potenconi lirshëm dhe unë po këtu do ta evidentoj dhe tani meqë jemi në fazën e hartimit të projekteve besoj se mund të bëjmë përpjekje për gjetjen mundësive për realizim.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, sërish ju falënderoj për këto informata sepse unë edhe pse jam në një mënyrë përfaqësues i komunitetit jo shumicë të gjitha gjërat nuk i di.

Unë do të interesohem dhe do të shikoj dhe vizitoj të 2 lagjet ku jetojnë komunitetet jo shumicë në Podujevë dhe do të marrë gjitha kërkesat e tyre dhe do t'ju sjellë në formë të shkruar në Drejtori.

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, theksoi, të kuptohemi drejtë, kur e thash këtë fjala ishte për vetëm kërkesa që janë me prioritet dhe që e vlerëson e tërë lagja se është e nevojshme, jo kërkesa individuale siç mund të jenë shembull për ndërtimin e rrugës me kubëza për një shtëpi e të ngjashme, pra vetëm kërkesa që prekin krejt lagjen dhe që ju e vlerësoni se është me prioritet dhe shumë e nevojshme, atë evidentojeni dhe besoj se brenda këtij viti do të kryhet.

z.Demokrat Hodolli, theksoi, kam një sugjerim që lagja në fjalë për të cilën u diskutua dhe që ka probleme me ujësjellësin, të paraqesin kërkesë në KRU “Prishtina” meqë u sqarua se kompetente është ajo kompani për shtrirjen dhe mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit.

Pra më e mira është që të parashtrohet kërkesë fillimisht nga vet komuniteti dhe e njëjta t’i drejtohet Kompanisë së ujësjellësit ngase Komuna gjithëherë do të shfajësohet duke thënë se nuk është kompetencë e imja, si dhe deri nesër e keni edhe dëshminë që keni paraqitur kërkesë e që mendoj se është më e rëndësishme.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, pyetje, a mund ta dërgoj si kërkesë projektin që e kemi bërë për ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit në lagjen ku jetojnë komunitetet jo shumicë në rr.”Ali Ajeti” në Podujevë, por përmes Komunës.

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, theksoi, po mund ta dorëzoni atë projekt edhe pse KRU “Prishtina” është kompani në vete dhe projektet i bën vet sepse i kanë edhe ekspertët e tyre.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, theksoi, falënderoj parafolësit për informata e dhëna dhe të sakta. Çështja e ujësjellësit në lagjen e cekur me të vërtetë u cek se është me gypa të asbestit, madje gypa të tillë janë edhe për krejt qytetin, mirëpo tek ajo lagje është paksa një problem tjetër, pra ta lëm anën e asbestit, sepse aty nuk ka kapacitet të shtypjes sipas informatave që kam sepse është rritë edhe lagja për nga numri i shfrytëzuesve të rrjetit ku aktualisht jetojnë 71 shtëpi të komunitetit Ashkalinj, 9 shtëpi të komuniteti Rom, dhe 2 familje të komunitetit Egjiptas e që në total kemi 82 familje me 466 banorë, shto kësaj edhe familje të komunitetit shumicë që jetojnë në atë lagje sepse nuk jetojnë vetëm familje të komuniteteve jo shumicë.

Pra duke parë kapacitetin e rrjetit në atë lagje ka nevojë për shtrirje të re dhe rritje të kapacitetit të ujësjellësit në mënyrë që të ketë sasi të mjaftueshme të ujit, kapacitete më të larta sepse është rritur lagja, dhe pse është bërë kjo është se DSHPMSH në bashkëpunim me KRU “Prishtina” si kompani fitimprurëse sikurse që është edhe KEDS e të tjera që janë e që normale që nuk i japin llogari Komunave pavarësisht që mund të kooperojnë dhe bashkëpunojnë mes vete, mirëpo kanë llogaritë dhe politikat e veta, andaj duke parë pozitivisht rëndësinë e këtij projekti dhe duke falënderuar inxhinierët e Kompanisë KRU “Prishtina”, drejtorin e Kompanisë, drejtorin dhe inxhinierët e DSHPMSH është bërë projekti dhe arsyeja përse është bërë janë ankesat dhe kërkesat që janë bërë në mbledhjet e Komitetit për Komunitete dhe përfaqësues tjerë të lagjes përkatëse ku jetojnë komunitetet jo shumicë.

Pastaj Zyra për Komunitete në kuadër të Zyrës së Kryeministrit ka kërkuar 3 projekte të cilat janë të rëndësishme dhe me arsye për komunitetet, dhe ne duke parë rëndësinë e projekteve prioritet ka qenë ky projekti për shtrirjen e ujësjellësit të ri në lagjen e cekur sepse dihet rëndësia dhe mungesa e ujit të pijes, janë dorëzuar tri projekte e që ndër to ka qenë edhe ky projekti për ujësjellës i cili ka qenë i nënshkruar edhe nga Kryetari i Komunës përveç nënshkrimit edhe nga ZKKK, projekt i cili është në detaje i përshkruar dhe me të gjitha matjet në terren dhe i cili është dorëzuar më 17.08.2022, mirëpo sipas asaj që na është thënë nuk është proceduar ende për shkak të mungesës së buxhetit, por që ende mendoj se ky projekt është i një rëndësie të veçantë për komunitetet që jetojnë në atë lagje, prandaj këtë projekt mund ta dërgoni edhe në KRU “Prishtina”.

Për këtë projekt është e njoftuar edhe Ministria e Administrimit të Pushtet Lokal, por që kjo Ministri më shumë ka pasë projekte për financimin e renovimit, riparimit të shtëpive të komuniteteve, mirëpo më gëzoj fakti që Ministri paska në plan të vizitoj Podujevën dhe sigurisht se do të ndan buxhet për realizmin e këtij projekti sepse kemi të bëjmë me një çështje e cila ka ndikim dhe efekt në terren jashtëzakonisht dhe që ndikon drejtpërdrejt te komunitetet jo shumicë në Komunën e Podujevës.

Pra kjo është ajo që deshta të ndërlihem me drejtorin e DSHPMSH dhe t'ju informoj se projekti është hartuar në bashkëpunim me DSHPMSH dhe KRU "Prishtina", andaj ju si komunitet e posedoni këtë projekt dhe lirshëm mund ta dorëzoni edhe në Kompaninë e Ujësjetllësit e cila pastaj si kompani profitabile mund të merret me këtë çështje dhe të bashkëpunoj edhe me DSHPMSH në funksion të realizmit të projektit.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, kërkesën për dorëzimin e projektit a mund ta bëjë vet personalisht në emër të lagjes përkatëse apo kërkesën ta parashtroj përmes Komunës.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, duke i'u përgjigjur parafolësit, theksoi, Komunës veç i'u keni drejtuar për realizmin e kësaj kërkesë / projekti dhe Komuna e ka përcjellë në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe në Zyrën për Qeverisje të mirë – Zyra për Komunitete në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, andaj normale që në emër të Lagjes në fjalë projektin dhe kërkesën për realizim mund ta dërgoni edhe në Kompaninë e Ujësjetllësit KRU "Prishtina" ku edhe mund ta cekni se kjo kërkesë është dërguar edhe në Komunë por tani dërgohet edhe tek ju si Kompani e Ujësjetllësit dhe kompetente për shtrirjen e rrjetit të ri të ujësjetllësit që edhe drejtori i DSHPMSH z.Bahri Selimi e sqaroj se kjo kompetencë ka kaluar në KRU "Prishtina".

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, theksoi, si përfundim konsideroj se e mira e krejt kësaj është që kërkesën ta drejtoni në KRU "Prishtina" dhe atë në emër të Lagjes edhe pse pak pritet që kjo Kompani të bëjë diçka, mirëpo gjasat më të mëdha janë tek Ministria e Administrimit të Pushtet Lokal e cila mund t'i transferoj mjetet financiare Kompanisë së Ujësjetllësit e cila pastaj e realizon projektin. Pra kjo është zgjidhja që pritet të bëhet, ndërsa juve ju mbetet që si Komunitet jo shumicë t'i drejtoheni me kërkesë Ministrisë së cekur sepse pa pasë një kërkesë të tillë atëherë edhe Ministria e ka paksa problem të ndaj mjete buxhetore ngase nuk i dinë problemet, prandaj ju përgatiteni kërkesën dhe dërgojeni edhe në KRU "Prishtina" qoftë në qendër atje në Prishtinë qoftë përmes Njësisë në Podujevë.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, ju falënderoj për këto sqarime, unë do ta përgatiti dhe do ta dorëztoj kërkesën këtu në njësinë në Podujevë dhe do të bisedoj me drejtorin e Njësisë.

Andaj meqë nuk ka të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës, e konstatoj të mbyllur me përfundimin e mësipërm që:

Në emër të Lagjes ku jetoj komuniteti jo shumicë në rr. "Ali Ajeti" në Podujevë, t'i drejtohem me kërkesë duke bashkëngjitur edhe projektin në fjalë, Kompanisë së Ujësjetllësit KRU "Prishtina" në mënyrë që të ndërmarin veprime për realizmin e projektit për shtrirjen e rrjetit të ujësjetllësit të ri në lagjen e cekur ku jetojnë komuniteti jo shumicë në Podujevë.

1. Informatë e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, për gjendjen socio – ekonomike, gjendjen e banimit dhe strehimit të familjeve të komuniteteve jo shumicë në Komunën e Podujevës.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, lidhur me këtë çështje ka ankesa nga komuniteti jo shumicë, madje është edhe një çështje tjetër ku DSHMS po ndodh që po i dërgon tek unë, pra Komuna nuk mund t'i zgjidh disa çështje por i'u thuhet shkoni tek përfaqësuesi juaj / tek unë dhe ata persona pastaj po vijnë tek unë dhe po paraqesin ankesa dhe kërkesa të ndryshme për të cilat unë nuk po mund t'iu bëjë zgjidhje, mirëpo po më duhet sërish të marrë personin përkatës dhe të vim sërish së bashku në Komunë, konkretisht tek ZKKK për të paraqitur ankesat dhe kërkesat e ndryshme të atyre personave të komunitetit jo shumicë.

Para se ta hapim këtë temë për diskutim, drejtori i DSHPMSH tani është prezent dhe mund të vazhdojmë aty ku mbetëm në pikën e parë të rendit të ditës.

(Ky deklaram i Kryesuesit ishte në fillim të mbledhjes pasi që u mbështet kërkesa që të vazhdohet me pikën e dytë të rendit të ditës deri sa të jetë prezent në mbledhje drejtori i DSHPMSH, mirëpo pas këtij diskutimi drejtori në fjalë ishte prezent dhe debati ri filloj për pikën e parë të rendit të ditës)

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, drejtoresha e Shëndetësisë është prezentë këtu dhe besoj se mund t'ia japim fjalën për sqarime dhe informim rreth kësaj teme.

znj.Adelinë Stublla, drejtoresh e DSHMS, theksoi, ne si drejtori gjatë këtyre muajve kemi ndihmuar me mjet financiare (nga mjetet vetanake) një numër të konsiderueshëm të familjeve të komuniteteve jo shumicë. Raste tjera të cilat kanë aplikuar për subvencionim për barëra janë në shqyrtim e sipër.

Në bashkëpunim me donatorë të ndryshëm janë ndihmuar 67 familje me pako ushqimore dhe hixhienike, pastaj kemi identifikuar edhe familje tjera të cilat janë në listë për donacionet e radhës, ndërsa rastet e kërkesave për veshmbathje dhe për miell janë drejtuar tek Kryqi i Kuq.

Rastet tjera që janë kryesisht me shumë prioritet për banim janë identifikuar dhe janë evidentuar në listën e pritjes që në rast të ofrimit të ndonjë donatori do të shqyrtohen të gjitha, e që vlen të theksohet se në listë të pritjes janë dy familje të cilat kanë pronë dhe planifikohet që të realizohen në momentin që të lajmërohen donatorët, në rastin konkret Hoxhë Halil Kastrati, kështu që ne si DSHMS vazhdojmë të kemi ndihmë për familjet në nevojë, në këtë rast për komunitete jo shumicë që jetojnë në Komunën e Podujevës.

Çka do që keni urdhëroni unë do të përpiqem t'ju jap sqarime dhe përgjigje të nevojshme.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, fillimisht ju falënderoj e nderuar drejtoresh, unë kam një kërkesë, fjala është për z.Ardian Sejdiu i cili është lajmëruar edhe këtu në Komunë dhe që jeton në Lagjen ku jehojnë komuniteti jo shumicë në rr."Xhafer Meta" në Podujevë, familja e të cilit është 11 anëtarësh dhe jeton në një dhomë me një kuzhinë, kështu që ai person është drejtuar në Komunë - DSHMS dhe zyrtarja përkatës znj.Arbresha Bashota e ka drejtuar tek unë, mirëpo unë t'ju them të drejtën nuk di se çfarë t'iu them familjeve të tilla që janë në nevojë kështu që përgjigja ime ishte, mirë që erdhe të më njoftosh mirëpo kjo punë është e Komunës, por pavarësisht kësaj nëse lajmërohet ndonjë donatorë apo diçka e ngjashme unë do të kem parasysht dhe po ashtu këtë çështje do ta ngris edhe në Komitet për Komunitete dhe në organet tjera komunale, kështu që tani ju kërkoj që në rast se paraqitet ndonjë donatorë apo vie ndonjë zgjidhje për këta persona të futet në listë të pritjes dhe të merret parasysht ky person dhe ajo familje sepse vërtetë janë në gjendje të keqe të banimit.

Familjen e z.Fadil Lahut ka qenë një Organizatë dhe e ka vizituar dhe tani pritet vetëm të fillohet me realizimin e donacionit për sigurimin e banimit.

Nuk kemi diçka me DSHMS e cila mund të themi se mirë i ka trajtuar familjet e komuniteteve jo shumicë qoftë me barëra qoftë me ndihma tjera të ndryshme, mirëpo sërish e kërkoj që në rast të ardhjes së ndonjë donatori apo në rast të gjetjes së ndonjë zgjidhje tjetër të merret parasysh familja e z.Fitim Sejdiut dhe z.Adrian Sejdiut dhe t'i gjendet zgjidhje për strehim ngase vërtetë janë në gjendje jo të mirë dhe janë kallaballëk fëmijë, kurse ndërtesa është tepër në gjendje të keqe e cila gjendet në Lagjen ku jetojnë komuniteti jo shumicë në rr."Xhafer Meta" në Podujevë.

znj.Adelinë Stublla, drejtoresh e DSHMS, theksoi, rastin e cekur nga parafolësi faktikisht ne si DSHMS jemi të njoftuar, e dim dhe e kemi trajtuar si rast. Zyrtarët përkatës të Drejtorisë kanë qenë dhe e kanë vizitua si rast dhe vërtetë kushtet e jetesën janë tepër të rënda dhe është vërtetë se janë 11 anëtarë, mirëpo esenca është që ai person nuk ka tokë/pronë të veten andaj është paksa problematike t'i sigurohet strehim përdërisa kur po lajmërohen donatorët ata po dëshirojnë ato familje që kanë prona të tyre, prandaj në këtë rast e kemi paksa më problem përveç nëse nëse lirohet ndonjë shtëpi në "Lagjen e Dëshmorëve", përndryshe kësaj familje nuk mund t'i bëjmë ndonjë zgjidhje të shpejtë, ndërsa sa i përket familjes së z.Fadil Lahut, normale se është në listë të pritjes dhe është vizituar nga Hoxhë Halil Kastrati, por që normale se është komisioni përkatës ai që vlerëson për më tutje.

znj.Shkurte Sejdiu, theksoi, te lista e ndihmës për barëra a mund të na tregoni se për cilat sëmundje bëhet fjalë që jepen këto ndihma.

znj.Adelinë Stublla, drejtoresh e DSHMS, përgjigje parafolëses, theksoi, është kriter i aplikimit për subvencionim për barëra dhe që vlerësohen pastaj nga komisioni përkatës, pra duhet të dorëzohen letërnjoftimi kopje, diagnoza apo raportet e mjekëve, analizat, faturat e barërave, identifikimi dhe konfirmimi i xhirollogarisë, dhe në momentin që drejtohen në DSHMS ato dërgohen tek Komisioni i cili pastaj i shqyrton. Pra prioritet janë diagnoza në këtë rast kanceri dhe leukemia, por nuk përjashtohen edhe sëmundje tera brenda mundësive buxhetore, andaj kjo më shumë konsiderohet si mbështetje morale se sa që është ndonjë ndihmë diçka më e madhe.

z.Demokrat Hodolli, theksoi, kam pyetje për drejtoreshën e DSHMS, sa është numri i kërkesave për ndërtimin e shtëpive në aspekt të përgjithshëm në Komunën e Podujevës, apo a ka ndonjë evidentim të tillë. E them këtë sepse mua më ka bërë përshtypje një bashkëbisedim me një qytetar të një komune tjetër i cili më ka thënë se në komunën ku jeton ai nuk ka asnjë kërkesë për ndërtimin e shtëpive të banimit, për çka jashtëzakonisht më ka ardhëm mirë.

znj.Adelinë Stublla, drejtoresh e DSHMS, theksoi, faktikisht tani që është ndërtuar Lagja e re na ka ndihmuar bukur shumë dhe i kemi strehuar një numër të familjeve në nevojë të strehimit e që në mesin e tyre është edhe një familje e komuniteteve jo shumicë. Pastaj edhe në "Lagjen e Dëshmorëve" e kemi strehuar një familje të komuniteteve jo shumicë e cila ka qenë tek hekurudha në qytet e që jemi në shqyrtim e sipër për të strehuar edhe një familje e cila është në atë hapësirë të hekurudhës ku edhe paraqitet kërkesë jashtëzakonisht e domosdoshme edhe për pastrimin e atij vendi i cili edhe për pamje nuk del mirë.

Sa i përket numrit të përgjithshëm të familjeve që kërkojnë strehim mund të them se janë rreth 120 familje të Komunës së Podujevës që kanë kërkesa për strehim dhe bëhet fjalë edhe për komunitetin shumicë edhe atë jo shumicë, mirëpo vlen të theksohet se shumica e tyre janë që dëshirojnë të ndahen nga bashkësitë familjare, do të thotë ne veç kemi ndërtuar shtëpi për ato familje por që tani shumica e atyre kërkesave prej atyre familje po kërkojnë edhe nga një shtëpi konkretisht po kërkojnë të ndahen për shkak të zgjerimit të shtëpive.

znj.Sevdije Mustafa, theksoi, e falënderoj drejtoreshën parafolëse për informata e dhëna dhe dua të jap si këshillë tani meqë edhe ministri i MAPL-ës është nga radhët e komuniteteve jo shumicë, t'i sugjeroni edhe atij për ndihmë komuniteteve o shumicë në Komunën e Podujevës meqë është mundësia tani të ndihmohemi si komunitet jo shumicë.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, dua të jap një sqarim parafolëse, ne kemi qenë tek ministri i MAPL-së dhe kemi paraqitur kërkesa ku nga Komuna e Podujevës janë rreth 40 të tilla.

Pra bashkërisht me shefin e ZKKK z.Liman Zeqiri, me ndihmën e Komunës kemi qenë tek Ministri i MAPL-së dhe i kemi përgatitur të gjitha kërkesat të cilat pastaj i kemi dorëzuar në këtë Ministri, mirëpo për Komunën e Podujevës nuk është marrë vendim.

Për komunitat tjera janë marrë vendime, por për Komunën e Podujevës jo dhe tani e them haptas se jemi anashkaluar si Komunë dhe nuk është marrë asgjë.

z.Florent Hasani, theksoi, përshëndesim përkushtimin e drejtoreshës së DSHMS në raport me ndihmën ndaj komunitetit jo shumicë në Komunën e Podujevës. Ne si Grup i LVV-së do të vazhdojmë të përkrahim dhe mbështesim punën e drejtoreshës së DSHMS dhe tërë Ekzekutivit në përgjithësi në shërbim të komunitetit jo shumicë në Komunën e Podujevës.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, theksoi, falënderoj parafolësit për të dhënat dhe informatat e dhëna, dhe t'ju them të drejtën Komuna e Podujevës është ndër komunitat më të mira që komunikon, bashkëpunon dhe bashkëvepron me institucionet për Komunitetet dhe këtë e them nga bindja duke qenë në prezent dhe pjesëmarrës në shumë forume të ndryshme, si dhe për faktin se jemi shumë Komunën e hapur dhe pothuajse të gjitha temat i diskutojmë hapur në mbledhjet e Komitetit për Komunitete si dhe i trajtojmë të gjitha kërkesat dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë enkas për komunitetet e që varësisht mundësive buxhetore ashtu siç e përmendi drejtoresha e DSHMS, ndihmohen por që mundësitë buxhetore nuk janë edhe aq të mëdha ngase kërkesa paraqiten edhe nga komuniteti shumicë, madje edhe kërkesa të personave që vijnë nga jashtë përmes riatdhesimit për banim e strehim sepse strehimi është paksa çështje e ndjeshme dhe delikate, por megjithatë më duhet të them se Qeveria e Kosovës si qeveri duhet të bëjë më shumë në kuptimin e asaj që ne kemi kërkuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal që e përmendi edhe znj.Sevdije Mustafa, ne bashkërisht me DSHMS-Sektorin e Strehimit që është znj.Arbresha Bashota i'u kemi ndihmuar për kompletimin e dokumentacionit që ka qenë konkurs i hapur nga dy Ministri siç është ajo për Komunitete dhe Kthim dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, kemi mbajtur takime me këto dy Ministri bashkërisht me zyrtaren e strehimit, dhe në këtë aspekt kanë shkuar 46 kërkesa për renovim të shtëpive, për ndërtim të shtëpive kanë qenë 6 kërkesa, prej tyre 3 familje nuk kanë prona dhe jetojnë me qira, për të cilat ne kemi kërkuar zgjidhje por që problemet janë tek pronat dhe Ministrinë këtë e shohin si problem, andaj për atë arsye ne kemi kërkuar të lehtësohen edhe kriteret në formularin e aplikacionit, madje as ne si komunitet shumicë që jemi një pjesë e madhe e jo na nuk i kemi pronat në emër tonë, prandaj çështja në fjalë ka qenë që të mundësohet aplikimi me certifikatë pronësore të ndonjë familjare të paktën për komunitetet jo shumicë e që ishte kërkesë e të gjitha komunave po thuajse, prandaj për këtë arsye nuk kanë mund të aplikojnë në ato thirrje për shkak se nuk kanë pasë pronë në emër të vetë apo edhe kanë mund të kenë prona të tyre por që nuk i kanë në emër të vet. Kërkesat / thirrjet për aplikim nga ana Ministrive kanë qenë për ndërtim, për renovim dhe për pajisje me mjete sanitare e që nga Komuna e Podujevës gjithsejtë kanë qenë 92 kërkesa nga 92 familje të ndryshme të komuniteteve jo shumicë që jetojnë në Komunën e Podujevës, për çka do të doja që këto të potencohen edhe në takimin e planifikuar me Ministrinë e MAPL-së, por edhe me Ministrin për Komunitete dhe Kthim.

Unë kam kontaktuar edhe me Ministrin e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim z.Nenad Rashiq dhe kur kam pyetur për këto çështje, përgjigja e tij ka qenë se sa ishte ministri para tij, pasuesi kur ka qenë në pyetje rindërtimi dhe kërkesat që kanë qenë, ishte një çështje që kompania ka përfituar ngase çmimet ishin jashtëzakonisht të larta, andaj kjo gjë është stopuar nga ministri aktual për hir të asaj që ndoshta kanë mund të ndërtohen 3 shtëpi me atë material që është planifikuar për 1 shtëpi me atë kompani që ishte sepse çmimet kanë qenë jashtëzakonisht të larta andaj për atë arsye është stopuar nga ministri aktual.

Pastaj nga këto dy Ministri unë kam kërkuar që kur të dalin komisionet dhe zyrtarët tjerë në vizita te familjet e komuniteteve jo shumicë në Komunën e Podujevës të kontaktohem edhe ne si ZKKK ngase t'ju them të drejtën unë i njohë të gjitha familjet e komuniteteve jo shumicë dhe atë ndoshta më mirë se vet ju si përfaqësues të tyre ngase punoj gjatë me ta dhe kam shënime të sakta për secilën familje sepse ka nevojë më shumë për t'i dhënë prioritet siç janë familja Lahu, pastaj familje tjera të cilat kanë kërkuar mbindërtim sepse janë familje të gjera dhe nuk kanë pronë por që kanë kërkuar mbindërtim në shtëpinë që e kanë të ndërtuar dhe nuk kanë mundësi dhe hapësira tjera për të ndërtuar shtëpi të re.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën për këtë pikë të rendit të ditës, nëse jo atëherë e konstatojmë të përfunduar dhe vazhdojmë me pikën radhës.

2. Të ndryshme

znj.Shkurte Sejdiu, theksoi, në procesin e regjistrimit të popullsisë kemi qenë disa persona të pranuar por për arsye të ndryshme disa janë larguar nga ky proces, disa kanë dhënë dorëheqje, një e kanë larguar sepse ka munguar në trajnime, ndërsa në Lagjen time ku jetoj në rr."Xhafer Meta" ku e kam pasë unë atë rajon e kanë angazhuar edhe një tjetër dhe mua më është thënë që t'i përdorë pajisjet e saj për regjistrimin e popullsisë, ndërsa kur kemi mbajtur trajnimet na është thënë që secili regjistruer i ka pajisjet e veta për të bërë regjistrimin e popullsisë në regjionin e vet që i është caktuar.

Kam paraqitur kërkesë në Agjencinë e Statistikave të Kosovës-ASK dhe më është thënë se të lajmërojmë lidhur me këtë rast, por që ende nuk kam marrë përgjigje.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, pyetje për parafolësen, theksoi, a jeni pranuar si regjistruer për regjistrimin e popullsisë.

znj.Shkurte Sejdiu, theksoi, po unë jam e pranuar në mënyrë të rregullt dhe e kam nënshkruar kontratën, por që pajisjet nuk më janë dhënë por që më kanë thënë të punoj me pajisje të koleges që i janë dhënë.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, pra siç po kuptoj unë t'i edhe pse je pranuar dhe e ke kryer testin nga trajnimi që keni mbajtur dhe keni nënshkruar kontratën, në momentin e fundit nuk ju janë dhënë pajisjet përkatëse për regjistrimin e popullsisë për çka je angazhuar.

Tani a keni bërë kërkesë ndokund për këtë çështje.

znj.Shkurte Sejdiu, theksoi, unë kam biseduar me zyrtar të ASK-së dhe jua kam shpjeguar rastin dhe përgjigja e tyre ka qenë se çdo regjistruer ka pajisjet e veta për zonën e vet, pastaj letrat njoftuese që dëshiron t'i shpërndaj në zonën ku është caktuar të regjistroj popullsinë.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, do të thotë se 2 regjistruer të popullsisë me 1 pajisje nuk mund të punojnë.

znj.Shkurte Sejdiu, theksoi, jo nuk mund të punojnë 2 persona me një pajisje sepse secili identifikohet me pajisjen e vet, me veshjen e vet dhe me gjitha dokumentet tjera përkatëse që i janë caktuar për zonën përkatëse.

znj.Liridona Rrahmani, zyrtare në Zyrën për informim dhe komunikim me publikun në Komunën e Podujevës, theksoi, nëse më lejohet, i rekomandoj parafolëses që të bisedoj me drejtorin e Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit sepse ai është koordinator për regjistrimin e popullsisë në territorin e Komunës së Podujevës, pra është përgjegjës dhe mund të ndikoj në zgjidhjen e këtij problemi

znj.Shkurte Sejdiu, theksoi, kam biseduar edhe me drejtorin e Drejtorisë së cekur dhe më ka thënë që të koordinohem me atë vajzën tjetër. Pra është në dijeni për këtë çështje.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, theksoi, pyes znj.Shkurte Sejdiu se a ka biseduar edhe me zyrtarin përkatës për territorin e Podujevës z.Mexhid Hasani i cili vie nga Ministria, dhe me atë mund t'i sqaroni këto.

znj.Shkurte Sejdiu, theksoi, po kam biseduar edhe me zyrtarin që e ceku z.Liman Zeqiri dhe më është thënë se janë përzier zonat, pra mua më kanë vë në lagjen e cila është në rr'Ali Ajeti" në Podujevë kurse atë vajzën tjetër e kanë vë në zonën ku jetoj unë dhe ku kam qenë e caktuar në lagjen e cila është në rr."Xhafer Meta". Pra i'a kam sqaruar të gjitha, por kur kam shkuar t'i marr pajisjet më është thënë se jeni bashkërisht me këtë vajzën tjetër dhe po ashtu edhe pajisjet i keni të përbashkëta, andaj në këtë situatë nuk po di çfarë të bëjë, e pranuar jam si regjistruese e popullsisë dhe më është caktuar zona.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, e nderuar ju e ngritët këtë çështje këtu në këtë mbledhje të Komitetit mirëpo ju i keni udhëheqësit dhe zyrtarët tjerë të ASK-së të cilët i dinë më mirë këto gjëra, andaj për mendimin tim mund të kontaktosh sërish dhe të sqaroheni në detaje, përndryshe mirë bëre që na informove lidhur me këtë rast.

Urdhëroni nëse ndokush tjetër dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e konstatoj të përfunduar edhe këtë pikë të rendit të ditës, përkatësisht këtë mbledhje.

Meqë nuk kishte të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesuesi i Komiteti e konstatoj të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00

**Procesverbalin e mbajti,
Enis Sheholli**

**Nr.Prot.01-060/04-0021431/24
Podujevë, 03 prill 2024**

**Kryesuesi i Komitetit
Xhafer Ademi**